



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 1061 prot.

Tiranë, më 03. 06. 2026

V E N D I M

Nr. 151, datë 03. 06. 2026

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 209 Regj., datë 25.09.2025, paraqitur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit³, përfaqësuar nga E. S., Drejtore Ekzekutive dhe Aleanca kundër Diskriminimit LGBT⁴, përfaqësuar nga Xh. K., Drejtore Ekzekutive, kundër S. C., në të cilën pretendohet për diskriminim në formën e gjuhës së urrejtjes për shkak të “identitetit gjinor” dhe “orientimit seksual”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve

Subjektet ankues, kanë parashtruar ndër të tjera se: “...Gjatë periudhës Shkurt 2024-Maj 2025, subjekti ndaj të cilit drejtohet ankesa, që përfaqëson një subjekt politik shqiptar ka bërë një deklaratë⁵, si pjesë e aksioneve publike, në formën e drejtpërdrejtë të komunikimit me publikun e gjerë. Gjatë këtij prononcimi publik, subjekti ka cenuar personat LGBTI+, për koncepte të lidhura me aspektet e orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Në shpjegim të kontekstit ku ka nisur kjo vazhdë daljesh dhe paraqitjesh publike, theksojmë se ka qenë një periudhë e qenësishme parapërgatitore për zgjedhjet e përgjithshme të Majit 2025 dhe si pjesë e fushatës zgjedhore që kryenin subjektet politike që ishin regjistruar si pjesëmarrës në garën zgjedhore. Ky moment ka qenë i përshtatshëm për të diskutuar publikisht ndër të tjera tema që prekin çështje të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, dhe përbën element kyç në paraqitjen e kësaj ankese, e cila pretendon se paraqitja publike e figurave të caktuara të përfaqësuesve të

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Në vijim referuar me KSHH.

⁴ Në vijim referuar me Aleanca LGBT.

⁵ <https://www.youtube.com/watch?v=N6B-m1--2Ek/>.

subjekteve politike para dhe gjatë fushatës zgjedhore në kuadër të zgjedhjeve të përgjithshme të Majit 2025, mbart elementë të diskriminimit të drejtpërdrejtë, gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes për të diskriminuar për shkak të karakteristikave të mbrojtura të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe përkatësisë në një grupim të veçantë.

Pretendojmë se konteksti dhe momenti në të cilin është kryer paraqitja dhe deklarata publike objekt i kësaj ankese, bën që të meritojë një vëmendje të shtuar, pasi efekti dhe impakti i saj në shoqëri gjatë kësaj periudhe ka qenë i amplifikuar, për shkak të vëmendjes së veçantë të publikut në kuadër të periudhës para zgjedhore.

Siç reflektohet në vendimmarrjen dhe standardet e vendosura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, standarde të cilat do të duhet të reflektohen drejtë në praktikën që shqyrtojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri (bazuar në parashikimet e neneve 5 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë), duke përfshirë këtu si një shtyllë qendrore institucionin e pavarur të KMD-së...

Duke ju referuar standardeve dhe testit mbi ekzistencën e elementeve të gjuhës së urrejtjes në jurisprudencën e GJEDNJ-së, pretendojmë se paraqitja publike e subjektit të kësaj ankese, si person i njohur gjerësisht në publik, gjatë periudhës së referuar në këtë ankesë, e cila përfaqëson një moment me rëndësi specifike politike, siç është periudha parazgjedhore dhe fushata zgjedhore e subjekteve politike, në lidhje me deklaratën që ka marrë përsipër të kryej kundrejt çështjeve dhe grupimit LGBTI+, një grupim tradicionalisht i diskriminuar në të drejta dhe dinjitet në shoqërinë Shqiptare, duhet të jetë objekt i një analize të kujdesshme nga KMD.

Më datë 25 Tetor 2024 gjatë një takimi publik S. C. ka deklaruar se: “Mos prisni asgjë nga ndërkombëtarët, OSBE çon formularët në Parlament dhe i pyet gratë dhe burrat çfarë gjinie keni ju. Çfarë gjinie kanë shqiptarët? Shqiptarët nuk janë pederastë. Ata janë burra dhe janë gra. Fëmijët tanë janë vajza dhe djem, dhe kjo duhet të jetë një vijë që nuk duhet të shkelet.”

Përmes kësaj ankese, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Aleanca LGBTI, si persona juridikë me interes legjitim, pasi kanë në misionin dhe statutin e tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pretendojnë se paraqitja mediatike e subjektit të mësipërm, përmban elementë që arrijnë të prekin nivelin e garancive dhe mbrojtjes së ofruar nga kuadri ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi, përkatësisht duke arritur nivelin e diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe duke nxitur urrejtje për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe përkatësisë në një grup të veçantë, mes përhapjes me qëllim dhe vetëdije të plotë të deklaratave publike mes medimeve të ndryshme, të cilat në tërësinë e tyre krijojnë dhe mbartin mundësinë të krijojnë në të ardhmen në shoqëri një perceptim denigrues, fytes, diskriminues dhe në përgjithësi negativ.

Në përmbushje të misionit dhe veprimtarisë së Komitetit Shqiptar të Helsinkit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut duke bashkëpunuar edhe me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me Aleancën LGBTI vlerësojmë se paraqitja e kësaj ankese është një mjet për të arritur në realizimin efektiv dhe real të këtyre të drejtave.

Shtetasja S. C., subjekt ndaj të cilit drejtohet kjo ankesë thërret publikisht se shqiptarët nuk janë pederastë. Ndër kohëra është një fakt i mirënjohur publik se fjala “pederast” mbart një kuptim

negativ ndaj personave gej dhe lesbike duke i lidhur ata me pedofilinë. Në thirrjet e saj S. C. shpreh qarte përbuzje ndaj personave LGBTI+, duke i portretizuar ata si persona që nuk përputhen me vlerat kombëtare dhe i rrezikojnë ato. Ajo vijon duke u shprehur se shqiptarët janë burra dhe gra, fëmijët tanë janë vajza dhe djem dhe kjo është një vijë që nuk duhet të shkelet. Burrat gej dhe gratë lesbike, si qytetarë shqiptarë janë gjithashtu burra dhe gra, të cilët nuk shkelin asnjë vijë siç portretizon S. C. në fjalimin e saj, që përmban nota të qarta diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Deklarata e subjektit në fjalë në përmbajtjen e saj dhe në tërësi krijon një perceptim negativ dhe thellon stigmën ndaj çdo personi LGBTI+, duke pretenduar se ky komunitet përbën risk shoqëror dhe duke bërë thirrje publike për mbrojtje të familjes shqiptare. Në tërësi deklarata publike është ndjekur mes platformës YouTube, pa llogaritur numrin e shikimeve që ka marrë në televizion në momentin që është shfaqur për publikun, numrin e personave që e ka dëgjuar direkt në hapësira publike, apo pas shpërndarjeve në rrjetet sociale, çka e bën atë të një rëndësie specifike. Ky portretizim i zgjatur në kohë dhe që në tërësinë e tij krijon një perceptim negativ, denigrues, diskriminues dhe fytes ndaj personave dhe lëvizjes LGBTI+, mbart potencialin të nxisë dhe thellojë diskriminimin dhe urrejtjen ndaj çdo personi LGBTI+ në vend.

Përfaqësuesit politikë, përfshirë deputetët, drejtuesit e partive, personat që punojnë në strukturat e partive politike dhe kandidatët në zgjedhje, gëzojnë një rol të thellë ndikues në formësimin e diskursit publik dhe të opinionit shoqëror. Për këtë arsye, ata mbartin një detyrim të shtuar për të mos përhapur gjuhë urrejtjeje, diskriminuese dhe përjashtuese, sidomos ndaj grupeve vulnerabël shoqërore. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar në mënyrë të përsëritur se aktorët politikë nuk janë “qytetarë të zakonshëm” në diskursin publik dhe se fjalët e tyre, veçanërisht gjatë periudhave para, gjatë dhe pas elektorale, kanë një peshë dhe ndikim të shumëfishtë. Në çështjen Feret kundër Belgjikës (nr. 15615/07, 2009), Gjykata mbajti qëndrimin se gjuha politike që përçan dhe nxit urrejtje justifikon ndërhyrje legjitime dhe të nevojshme nga shteti. Po ashtu, në çështjen Zemmour kundër Francës (nr. 63539/19, 2022), GJEDNJ ripohoi se retorika përjashtuese dhe përçarëse e përdorur nga figura publike që synon të përjashtojë grupe të caktuara nga identiteti kombëtar klasifikohet jashtë mbrojtjes së nenit 10 të Konventës...

Në këtë kuadër, është e domosdoshme që deklaratat publike të përfaqësuesve politikë të vlerësohen jo vetëm si ushtrim i lirisë së shprehjes, por edhe në dritën e ndikimit të tyre të drejtpërdrejtë në krijimin e një klime sociale të mbushur me intolerancë dhe stigmatizim, veçanërisht ndaj personave LGBTI+, të cilët shpesh janë në qendër të fushatave polarizuese dhe diskursit përjashtues. Këto deklarata, nëse mbartin elemente të urrejtjes, kanë kapacitetin të dëmtojnë jo vetëm individët në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe vete strukturën demokratike të përfaqësimit dhe barazisë në shoqëri.

Pretendimet përfundimtare:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Aleanca LGBTI, depoziton këtë ankesë në funksion të inkurajimit të përmbushjes së qëllimit të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përkatësisht

përcaktuar në nenin 2/c të tij, si një instrument për të ofruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për çdo qytetar në vendin tonë, pavarësisht karakteristikave të mbrojtura që mbart.

Së pari, pretendojmë se paraqitja publike e S. C., në momentin e sipërcituar, mbart elemente të qarta të diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet përdorimit të gjuhës së urrejtjes për shkaqe që kanë të bëjnë me orientimin seksual dhe identitetin gjinor, ndaj komunitetit LGBTI+. Kjo deklaratë, ky portretizim dhe targetim i drejtpërdrejtë nuk do të kishte ndodhur nëse nuk do të kishim të bënim me persona dhe aktivistë LGBTI+, çka në vetvete tregon se ky grup personash është duke u trajtuar publikisht nga subjektet në fjalë në mënyrë më pak të favorshme krahasuar me një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme (pjesa tjetër e shoqërisë shqiptare), bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe përkatësinë në një grup të veçantë si shkaqe të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

Së dyti, pretendojmë se këto paraqitje publike, në momentet e sipërcituara, mbart elemente të qarta të gjuhës së urrejtjes, pasi përbën shprehje në publik që dizinformojnë, promovojnë dhe nxisin denigrim, urrejtje, shpifje, fyerje, stereotipizime negative, intolerancë dhe stigmatizim ndaj personave dhe aktivistëve LGBTI+ në dallim nga pjesa tjetër e shoqërisë.

Së treti, pretendojmë se deklaratata, në momentet e sipërcituara mbart elemente të nxitjes për diskriminim, pasi mes thirrjeve të cituara në këtë ankesë, nxisin shumë persona të tjerë të bashkohen me qëndrimet e tyre në emër të mbrojtjes së supozuar të familjes shqiptare nga rreziku që sjell komuniteti LGBTI+, duke e pozicionuar sërish këtë komunitet në një fokus denigrues, stereotipizues dhe negativ, si risk që kanoset përkundrajt fëmijëve dhe pjesës tjetër të shoqërisë.”

Sakaq, subjektet ankues kërkojnë nga Komisioneri, shqyrtimin e kujdesshëm të kësaj ankese dhe marrjen e një vendimi të drejtë që tregon kujdes të veçantë në konsiderimin e raportit të hollë mes lirisë së shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes, si dhe konstatimin e elementeve të ndryshme diskriminuese në lidhje me momentet e parashtruara më sipër, në funksion të shmangies dhe parandalimit të praktikave të rrezikshme për demokracinë dhe të drejtat e njeriut në Shqipëri.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në

nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, shkronja “b”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund ta bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD, përcaktohet se: “Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit”.

Së pari, nga aktet e administruara rezulton se palët ankuese, Shoqata “Komiteti Shqiptar i Helsinkit” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 17/1, datë 12.01.1991 dhe Qendra “Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT”, është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik me vendimin nr. 567, datë 10.11.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur palët e mësipërme ankuese, ato nuk pretendojnë se janë cenuar në interesin e tyre të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, por pretendojnë se gjuha e përdorur dhe e shpërndarë nga ana e subjektit kundër të cilit kanë paraqitur ankesën, diskriminon komunitetin LGBTI dhe përbën gjuhë urrejtje për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual.

Palët ankuese Komiteti Shqiptar i Helsinkit është organizatë jofitimprurëse, e cila ka në misionin e saj mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut për çdo person në Shqipëri, ndërsa Aleanca

Kundër Diskriminimit LGBT, është organizatë jofitimprurëse e krijuar me qëllimin për të promovuar dhe për të mbrojtur të drejtat e komunitetit LGBT në Shqipëri.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së palëve ankuese dhe çështjes që këto organizata kanë paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesit legjitimohen para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Së dyti, Komisioneri thekson se, fillimisht palët ankuese kanë depozituar një ankesë të vetme duke pretenduar përdorimin e gjuhës së urrejtjes nga disa subjekte, konkretisht kundër S. C., E. R., S. B., F. M., A. L., T. B., si dhe subjektit të kësaj ankese B. Xh.

Referuar parashtrimeve të paraqitura në ankesë, rezultoi se deklaratat e pretenduara si gjuhë urrejtje nga ana e të gjithë subjekteve të mësipërme ishin bërë në momente të ndryshme kohore dhe gjithashtu, shkaqet e pretenduara si diskriminuese, përveç shkaqeve të identitetit gjinor dhe orientimit seksual, konsistonin në gjendjen shëndetësore, aftësinë e kufizuar dhe përkatësinë në një grup të veçantë.

Në këto kushte, Komisioneri vijoi shqyrtimin e pretendimeve të paraqitura nga palët ankuese të ndara sipas subjektit i cili pretendohet se ka përdorur gjuhë urrejtje.

Së treti, Komisioneri kreu verifikimet në lidhje me materialin e pretenduar nga palët ankuese objekt i ankesës. Në cilësinë e provës lidhur me deklaratën e pretenduar diskriminuese, palët ankuese kanë vendosur në dispozicion *Link-un*: <https://www.youtube.com/watch?v=N6B-m1--2Ek/>.

Nga verifikimi i link-ut, Komisioneri mundi të administrojë një pjesë të fjalimit ku pasqyrohet përmbajtja e deklaratës së bërë nga subjekti S. C., që pretendohet se përbën gjuhë urrejtje. Më datë 25 tetor 2024 gjatë një takimi publik, protestës së zhvilluar përpara Bashkisë së Tiranës, S. C. ka deklaruar ndër të tjera se: *“Mos prisni asnjë gjë nga ndërkombëtarët. OSBE çon formularët në Parlament dhe i pyet gratë dhe burrat çfarë gjinie keni ju, çfarë gjinie kanë shqiptarët? Shqiptarët nuk janë pederastë. Shqiptarët janë burra dhe shqiptarët janë gra. Fëmijët tanë janë vajza dhe djem, dhe kjo duhet të jetë një vijë e cila nuk duhet të shkelet. Ka ditë, ka muaj, ka vite që po tentohet të shkelet. Është agjendë, e kemi paralajmëruar. E kemi paralajmëruar dhe jam shumë e bindur që shqiptarët dita ditës po e kuptojnë...”*. Pala ankuese përveç *Link-ut*, nuk vendosi në dispozicion ndonjë kopje të videos ku pretendohet se gjen pasqyrim deklarata e bërë nga subjekti S. C..

Referuar parashtrimeve të bëra në ankesë nga ana e palëve ankuese, përveç përmbajtjes së deklaratës së pretenduar si gjuhë urrejtje dhe datës kur pretendohet se është bërë ajo nga ana e subjektit S. C., konkretisht datë 25.10.2024, nuk jepen të dhëna të tjera në lidhje me vendin apo natyrën e aktivitetit, përveç parashtrimeve të bëra në pjesën hyrëse të ankesës, ku theksohet fakti se deklaratat janë publike dhe se janë bërë në kuadër të periudhës parapërgatitore për zgjedhjet e

përgjithshme të Majit 2025, si pjesë e fushatës zgjedhore që kryenin subjektet politike që ishin regjistruar si pjesëmarrëse në garën zgjedhore.

Sa më sipër, ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe, në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të tij, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1293/2 prot., datë 16.10.2025, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga S. C., lidhur me pretendimin e subjekteve ankues.
2. Duke qënë se nga ana e S. C., nuk është vënë në dispozicion të Komisionerit asnjë përgjigje, me anë të shkresës nr. 1293/3 prot., datë 18.11.2025, Komisioneri i dërgoi subjektit një rikujtesë lidhur me shkresën nr. 1293/2 prot., datë 16.10.2025.
3. Përmes e-mail-it datë 27.01.2026, S. C. iu drejtua Komisionerit duke vënë në dispozicion parashtrimet e saj sa i përket pretendimeve të ngritura në ankesë nga subjektet ankues, duke referuar ndër të tjera se: *“Në datën 25.10.2024, gjatë një proteste të mbajtur nga forcat politike opozitare, përpara Bashkisë së Tiranës, gjatë fjalës time kam adresuar çështjen e propagandimit të agjendës LGBT në institucione, kryesisht ato të arsimit parauniversitar, tek fëmijët dhe të rinjtë.*

Nga shkresa Juaj, kuptoj që pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pothuajse një vit pas kësaj deklarate, që përkon edhe me emërimin tim në detyrën e Zv. Ministrit të Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë, kanë ardhur ankesa, me pretendimin për diskriminim, për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual, si pasojë e përdorimit të fjalës “pederastë”, gjatë fjalës time në këtë protestë.

Së pari, përdorimi i kësaj fjale, ka ardhur sepse, sipas njohurive të mia, të cilat sigurisht mund të jenë të cinguara, në gjuhën shqipe, nuk ka një përkthim të fjalës “gay”, e cila gjendet edhe në akronimin LGBTQIA+. Fjala “homosexual”, në gjuhën shqipe gjen përkthim në fjalën “homoseksual”, ndërsa fjala “gay”, kam menduar se përkthehet “pederast”. Për asnjë arsye nuk kam patur qëllim diskriminimin apo fyerjen dhe nxitjen e urrejtjes nëpërmjet kësaj fjale, kur dihet që në gjuhën shqipe, kryesisht në gjuhën e përdorur në përditshmëri, kur përshkruhen marrëdhëniet seksuale brenda së njëjtës gjini, ka të tjera fjalë të cilat kanë konotacion negativ dhe mund të konsiderohen diskriminuese, ofenduese, fyese apo nxitëse të urrejtjes.

Së dyti, qëndrimet e secilit prej nesh, nuk varen vetëm nga fjalët, por mbi të gjitha nga veprimet konkludente, të cilat shprehin vullnetin në mënyrë përfundimtare. Për të shpjeguar këtë, Ju bëj me dije se, si në cilësinë e ish-deputetes së Kuvendit të RSH (Dhjetor 2013 - Shkurt 2019), anëtare e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut, ashtu edhe në cilësinë e anëtares së Këshillit Bashkiak Tiranë, për çdo iniciativë ligjore apo nënligjore në të cilat favorizohet pozita e komunitetit LGBTQIA+, apo anëtarëve të saj, kam votuar gjithnjë në

favor të përmirësimit të pozitës së tyre, votime të cilat janë publike dhe Ju si Komisioner mund t'i verifikoni me një kërkesë drejtuar Kuvendit të RSH apo edhe Këshillit Bashkiak Tiranë.

Si një shembull për të faktuar pretendimin e mësipërm, mund t'ju sjell projektvendimin e miratuar në KB Tiranë, një vit më parë, mbi subvencionimin e interesave të kredisë nga Bashkia e Tiranës, ku në sistemin e pikëzimit, anëtarët e komunitetit LGBTQIA+, përfitonin 2 pikë më shumë. Ky projektvendim është votuar në favor nga ana ime, çka tregon edhe një herë se për asnjë moment nuk kam patur për qëllim diskriminimin apo fyerjen. Madje, mendoj se është tregues i faktit që gjatë kryerjes së detyrave publike, jam përpjekur të respektoj jo vetëm legjislacionin e vendit tonë, por edhe të drejtat e kujtdo. Për mua, të drejtat e njeriut nuk nënkuptojnë vetëm të drejtat e anëtarëve të komunitetit LGBTQIA+, por të drejtën e kujtdo individi, për të mos u ndjerë i cënuar apo i imponuar nga një palë tjetër.

Së treti, më lejoni të shpreh konsideratën time mbi ankesën e ardhur tek Ju, e cila, sipas mendimit tim, nuk vjen si pasojë e të ndjerit të fyer apo të diskriminuar, por si një formë "hakmarrjeje". Më lejoni t'Ju kujtoj se nga fjalimi im në protestë (25 Tetor 2024), e deri në depozitimin e ankesës ndaj meje (25 Shtator 2025), ka kaluar një kohë e konsiderueshme, pothuajse një vit kalendarik, gjatë të cilit ankuesit kishin kohën e mjaftueshme për të depozituar ankesën e tyre, aq më tepër që edhe në kohën e kryerjes së kësaj deklarate, unë isha një person publik dhe politik, duke qënë se që prej Qershorit 2023, mbaj mandatin e anëtares së Këshillit Bashkiak Tiranë. Por, depozitimi i ankesës pikërisht ditën e emërimit në detyrën e Zëvendës Ministrit të Punëve të Brendshme, nuk tregon në të vërtetë ndjeshmëritë e Aleancës apo anëtarëve të saj, ndaj një fjale të përdorur nga unë, aq më tepër gjatë një proteste, ku botërisht dihet që në protesta, fjalët apo veprimet mund të përshkallëzohen, në varësi edhe të situatave në të cilat mbahen.

Megjithatë, duke patur qëllim mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga fenomene të cilat në gjykimin tim janë të pashëndetshme, për arsye të moshës së hershme dhe mungesës së perceptimit të duhur të koncepteve të ndryshme lidhur me homoseksualitetin, për arsye të kontekstit shoqëror dhe moral në të cilin jetojmë, si dhe për arsye objektive, ku këto marrëdhënie janë ende të paligjëruara, si dhe duke mos patur për qëllim fyerjen apo diskriminimin, dëshiroj që nëpërmjet Jush, edhe si një individ që beson tek të drejtat e njeriut, si nënë dhe mbi të gjitha si njeri që e ka të shenjtë jetën dhe shëndetin e kujtdo, qofshin këta homoseksualë apo jo, t'i kërkoj ndjesë çdokujt, që nga ajo deklaratë është ndjerë i diskriminuar. Për asnjë moment nuk kam patur qëllim diskriminimin, por vetëm mbrojtjen e një ideje, të cilën unë e besoj dhe e vlerësoj si të drejtë, të paktën për aq kohë sa realiteti ynë shoqëror, moral dhe ligjor mbetet në fuqi dhe nuk ka ndryshuar."

4. Sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i përcolli subjekteve ankues përmes e-mail-it datë 27.02.2026, parashtrimet e sipërcituara të S. C. dhe kërkoj nga ana e tyre të depozitojnë qëndrimin e tyre lidhur me to.

Përmes e-mail-it datë 06.03.2026, subjektet ankues, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Aleanca kundër diskriminimit LGBT, në përgjigje të parashtrimeve të S. C., referuan ndër të tjera se: “...Ne i përmbahemi ankesës sonë, por paraqesim qëndrime lidhur me përgjigjen konkrete të mbajtur nga subjekti ndaj të cilit është paraqitur ankimi. Subjekti ndaj të cilit është bërë ankim për shkelje të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, rezulton se në kohën e realizimit të deklaratës që përmban **gjuhë urrejtje**⁶ për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual, ashtu siç edhe prapëson në qëndrimin e saj, rezulton se ka qenë në ushtrim të funksioneve publike dhe konkretisht të anëtares së Këshillit të Bashkisë Tiranë. Përdorimi i kësaj gjuhe ka për qëllim cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, përçmues, poshtërues e ofendues për shkak të për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual.

Lidhur me qëndrimin e subjektit ndaj të cilit është bërë ankimi, parashtrojmë si vijon:

Së pari, përdorimi i kësaj fjale, ka ardhur sepse, sipas njohurive të cunguara, në gjuhën shqipe, nuk ka një përkthim të fjalës “gay”, e cila gjendet edhe në akronimin LGBTQIA+. Fjala “homosexual”, në gjuhën shqipe gjen përkthim në fjalën “homoseksual”, ndërsa fjala “gay”, kam menduar se përkthehet “pederast”.

Rezulton, se sipas praktikave dhe standardeve më të mira ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përdorimi i fjalës “pederast”, konsiderohet me konotacion diskriminues dhe fyes. Konkretisht:

1. Përdorim si fyerje ndaj personave LGBT+.

Në shumicën e gjuhëve, termi përdoret si etiketim nënçmues për burra homoseksualë, duke bartur ngarkesë negative dhe stigmatizuese.

2. Ngatërrim me pedofilinë.

Historikisht, fjala ka pasur kuptime të ndryshme, por sot shpesh përdoret në mënyrë të pasaktë që sugjeron lidhje me sjellje kriminale (pedofili), gjë që është e rreme dhe thellësisht stigmatizuese për personat me orientim homoseksual.

3. Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Organizma ndërkombëtarë si OKB dhe KE, si dhe jurisprudenca e GJEDNJ, theksojnë mbrojtjen nga gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi mbi bazë orientimi seksual. Përdorimi i termave nënçmues bie ndesh me këto standarde.

Deklarata se: “Shqiptarët nuk janë pederastë”

Kjo përmban dy elemente problematike të cilat kanë synim të vendosin një grup kombëtar në kundërvënje me një identitet seksual, me nënkuptim se të qenit shqiptar është e ndryshme nga të qenit homoseksual, duke e paraqitur identitetin seksual si kundërvlerë kombëtare, diçka negative, e huaj ose e papranueshme.

Në kontekstin juridik dhe etik, fjala “pederast” konsiderohet me konotacion diskriminues dhe përdorimi i saj publik, veçanërisht në mënyrë etiketimi, bie ndesh me standardet ndërkombëtare të mos-diskriminimit.

Së dyti, “qëndrimet e secilit prej nesh, nuk varen vetëm nga fjalët, por mbi të gjitha nga veprimet konkludente, të cilat shprehin vullnetin në mënyrë përfundimtare”.

⁶ si formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një grupi personash

Ky argument nuk është juridikisht i qëndrueshëm për tre arsye:

1. Diskriminimi konsiston në deklaratë publike

Sipas praktikës së GJEDNJ deklaratat publike nga figura politike kanë peshë të veçantë dhe fjalët e tyre, ndikojnë në klimën shoqërore. Gjykata ka theksuar se politikanët kanë përgjegjësi të shtuar për të shmangur gjuhën që nxit intolerancë.

2. Veprimet e mëparshme apo të mëvonshme pro-LGBTQ+ nuk neutralizojnë deklaratën.

Edhe nëse votimet, në ushtrim të funksioneve publike, kanë qenë në favor të komunitetit, kjo nuk përjashton përgjegjësinë për një deklaratë konkrete diskriminuese. Pra, veprime konkludente nuk përbëjnë “imunitet reputacional” nga diskriminimi. Imuniteti reputacional (një “mburojë” reputacioni të mirë) është aftësia për të ruajtur besimin dhe kredibilitetin tek palët e interesuara, por nuk e justifikon përdorimin e gjuhës së urrejtjes për shkak të përkatësisë seksuale. Referimi ndaj “realitetit moral” për mbrojtjen e fëmijëve apo zakoneve shqiptare, nuk e legjitimon përdorimin e terminologjisë stigmatizuese dhe nuk përjashton përgjegjësinë për efektin diskriminues.

Së treti, “shpreh konsideratën time mbi ankesën e ardhur, e cila, sipas mendimit tim, nuk vjen si pasojë e të ndjerit të fyer apo të diskriminuar, por si një formë “hakmarrje”. [...] depozitimi i ankesës pikërisht ditën e emërimit në detyrën e Zëvendës Ministrit të Punëve të Brendshme, nuk tregon në të vërtetë ndjeshmëritë e Aleancës apo anëtarëve të saj, ndaj një fjale të përdorur nga unë, aq më tepër gjatë një proteste, ku botërisht dihet që në protesta, fjalët apo veprimet mund të përshkallëzohen, në varësi edhe të situatave në të cilat mbahen”.

Subjekti ndaj të cilit është paraqitur ankimi, përdor viktimizimin, që vjen si reagim ndaj një pretendimi, që synon zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit. Konkretisht, ankimi i paraqitur, nuk ka kontekst politik dhe përfshin qëndrimet e disa figurave publike të spektrit politik në Shqipëri dhe përfshin një periudhë të gjerë kohore, duke nisur nga të paktën shkurt 2024 dhe deri në të paktën maj 2025.

Ndjeshmëria e ankuesit ndaj përdorimit të gjuhës së urrejtjes në fakt bazohet në një trajtim objektiv dhe pasojave të padëshiruara, fokusohet në objektivitetin dhe përmbajtjen e deklaratës publike dhe efektin e saj.

Argumenti se deklarata është bërë “gjatë një proteste”, ku fjalët mund të përshkallëzohen, e rëndon edhe më shumë përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Figurat publike dhe politikanët, kanë detyrim të shmangin deklarata që nxisin intolerancë, veçanërisht në situata tensioni.

Përkundër këtij qëndrimi, në ambiente proteste, përgjegjësia mund të jetë më e lartë, për shkak të ndikimit emocional dhe përhapjes së shpejtë të mesazhit.”

5. Sakaq, Komisioneri përmes e-mail-it datë 09.03.2026, iu drejtua S. C., duke i përcjellë përgjigjen e vënë në dispozicion nga ana e subjekteve ankues, si dhe duke i kërkuar të paraqesë qëndrimin e saj lidhur me to brenda datës 13.03.2026.

Në kushtet kur, S. C. nuk vuri në dispozicion qëndrimin e saj përse më sipër, Komisioneri vazhdoi trajtimin e ankesës në bazë të provave të depozituara, bazuar dhe nga verifikimi i përmbajtjes së

fjalimit të mbajtur në protestën e zhvilluar pranë Bashkisë Tiranë më datë 25.10.2024 që aksesohet online në rrjetin social *YouTube* në linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=N6B-m1--2Ek/>.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje objekt i ankesës dhe që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

III. Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes nga Komisioneri

Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, janë bazat e shtetit të së drejtës. Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i cenojë vetë ato, por ai duhet të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të garantuar mos cenimin e tyre nga privatët, pra shteti duhet të marrë të gjitha masat për t’i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët. (Neni 3, i Kushtetutës së Shqipërisë)

Barazia dhe mosdiskriminimi, janë gur themeli i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në nenin 18, të saj, Kushtetuta sanksionon : *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlikje e arsyeshme dhe objektive.”*

Barazia dhe mosdiskriminimi janë gur themeli edhe e të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtave të njeriut, të cilat janë ratifikuar nga vendi ynë duke u bërë pjesë të rendit të brendshëm juridik, menjëherë pas Kushtetutës dhe me epërsi ndaj ligjeve kombëtare.

Shqipëria ka nënshkruar Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në vijim *KEDNJ*), e cila në nenin 14, ndalon diskriminimin dhe detyron shtetet anëtare që të garantojnë gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë pa diskriminim bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke sanksionuar: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*, si dhe Protokollin Nr. 12 të *KEDNJ*-së, i cili i detyron shtetet anëtare të garantojnë gëzimin pa diskriminim të të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm. Duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme, *KEDNJ*, në referim edhe të evokimit që i bëhet asaj në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë logjike edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (*GJEDNJ*), me anë të të cilave bëhet interpretimi i Konventës, kanë fuqinë e Konventës.

Vendi ynë ka ratifikuar shumë prej traktateve për të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara, ndër të tjera, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i cili në nenin 2, pika 1, përcakton: *“1. Çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet të respektojë dhe t’u sigurojë të gjithë njerëzve që ndodhen në territorin e tij dhe që varen nga juridiksioni i tij, të drejtat e njohura në këtë Pakt, pa kurrfarë dallimi të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri, lindje ose çdo shkak tjetër.”*, ndërsa në nenin 26, ky Pakt sanksionon: *“Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinion tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo shkak tjetër.”*

Liria e shprehjes është një e drejtë Kushtetuese, e parashikuar nga neni 22, ku sanksionohet: *“Liria e shprehjes është e garantuar.”*

Liria e shprehjes garantohej edhe në kuadër të akteve të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë. Në nenet 9 dhe 10 të KEDNJ-së, përcaktohet :

“Neni 9 - Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.

2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t’i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tjerëve

Neni 10- Liria e shprehjes

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

Liria e shprehjes garantohet edhe në kuadër të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Në nenin 19, të Paktit, sanksionohet se: *“1. Secili duhet të ketë të drejtën e opinionit pa ndonjë ndërhyrje. 2. Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, goftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij. 3. Ushtrimi i lirive të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nënkupton detyra dhe përgjegjësi të posaçme. Për rrjedhojë ai mund t'u nënshtrohet disa kufizimeve të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme: (a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve; (b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.”*

Liria e shprehjes, përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë dhe për të shprehur ose për të dhënë informacione dhe ide, pa ndërhyrje. Liria e mendimit dhe e shprehjes janë thelbësore për çdo shoqëri dhe përbëjnë gurin e themelit për zhvillimin e çdo personi dhe çdo shoqërie të lirë dhe demokratike.

Liria e mendimit, nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi apo ndërhyrje. Asnjë person nuk mund të jetë subjekt i asnjë ndalimi ose kufizimi, për shkak të mendimeve/opinioneve të tij aktuale, të perceptuara apo të supozuara. Të gjitha format e mendimit janë të mbrojtura, duke përfshirë mendimet politike, shkencore, historike, morale ose të natyrës fetare. Liria e shprehjes, përfshin, shprehjen/dhënien dhe marrjen e komunikimeve në çfarë do lloj forme të ideve dhe mendimeve, të cilat janë të transmetueshme tek të tjerët. Kjo lloj lirie nuk është absolute dhe është subjekt i kufizimeve. Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi.

Liria e shprehjes është subjekt i kufizimeve, sipas përcaktimit të nenit 17, të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite Kushtetuese, kufizimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Referuar KEDNJ, kufizimi i këtyre të drejtave përcaktohet nga neni 9/2 dhe 10/2.

Këto parashikime shkojnë në të njëjtën linjë edhe me rregullimin dhe nivelin e kufizimeve të zbatueshme për këto të drejta, të parashikuara nga traktatet e të drejtave të njeriut në kuadër të Kombeve të Bashkuara, të cilat vendi ynë i ka ratifikuar, sikurse është Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike. Ky traktat i të drejtave të njeriut rregullon ushtrimin dhe kufizimet e zbatueshme për këto të drejta në nenet 18/3 dhe 19/3 të tij.

Toleranca dhe respekti për dinjtet të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si një çështje parimi mund të konsiderohet e nevojshme që në shoqëri të caktuara demokratike të dënohen apo edhe të

parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen të bazuar tek mungesa e tolerancës. (*Erbakan kundër Turqisë, vendimi 6 korrik 2006, paragrafi 56*)

Mbështetur në paragrafin 2, të nenit 10 të KEDNJ-së, autoritetet vendase në çdonjërin nga Shtetet Kontraktues mund të ndërhyjnë me ushtrimin e lirisë së shprehjes, kur plotësohen 3 (tre) kushte së bashku⁷:

1. Ndërhyrja (në kuptimin e “formalitetit”, “kushtit” ose “sanksionit”) parashikohet me ligj;
2. Ndërhyrja ka si qëllim të mbrojtë një ose më shumë nga interesat ose vlerat e mëposhtme: sigurimin kombëtar; integritetin territorial; sigurinë publike; ndalimin e krimit dhe mbrojtjen e rendit; mbrojtjen e shëndetit; moralit; reputacionin ose të drejtat e të tjerëve; ndalimin e zbulimit të informacionit të marrë në konfidencë, dhe garantimin e autoritetit të paanshmërisë së gjyqësorit;
3. Ndërhyrja është e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Nevoja për të mbrojtur “*të drejtat e të tjerëve*” është një moment i rëndësishëm kufizues për të drejtën e shprehjes. Në çështjen *Engels and Others*, GJEDNJ është shprehur se: “*nuk ka arsye që të mohosh lirinë e shprehjes, por vetëm të dënosh ushtrimin abuziv të asaj lirie.....*”⁸.

Në nenin 3, pika 1, të LMD, sanksionohet se: “*1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.*”

Një nga format e shfaqjes së diskriminimit, është “*gjuha e urrejtjes*”, e cila përkufizohet në pikën 8, të nenit 3, të LMD, sipas përkufizimit vijues: “*8. “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.*”

“*Gjuha e urrejtjes*”, si një nga format e shfaqjes së diskriminimit, është e ndaluar nga neni 5, pika 1, e LMD, ku sanksionohet se: “*1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.*”

⁷ Carss-Frisk, M., Një udhëzues për zbatimin e Nenit 10 të Konventës Evropiane - Liria e Shprehjes;

⁸ Engels and Others kundër Hollandës, 1976.

Shteti shqiptar është angazhuar për të marrë masat për luftën kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, duke formalizuar vullnetin e tij përmes nënshkrimit të Rekomandimit CM/Rec(2010)5 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës *“Mbi masat për të luftuar diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”*, miratuar në datë 31.03.2010. Komiteti i Ministrave, rekomandon shtetet që të marrin masa në drejtim të garantimit të të drejtës për jetën, sigurinë dhe mbrojtjen nga dhuna, të personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të tyre. Në kuadër të garantimit të kësaj të drejte, rekomandohet që: *“Shtetet anëtare të marrin masat e nevojshme për të luftuar të gjitha format e shprehjes, të cilat mund të kuptohen në mënyrë të arsyeshme se prodhojnë efektin e nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit kundër lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transeksualëve, duke përfshirë median dhe internetin. “Fjalimet e urrejtjes” ndalohen dhe dënohen publikisht. Të gjitha masat respektojnë të drejtën themelore për lirinë e shprehjes, në përputhje me nenin 10 të Konventës dhe jurisprudencën e Gjykatës”*.

Rekomandimi Nr. 15 i Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) *“Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”*, miratuar më 8 Dhjetor 2015⁹, e përkufizon “gjuhën e urrejtjes”: *“gjuha e urrejtjes duhet të kuptohet si avokim, promovim apo nxitje në çfarëdo formë të denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi apo grupe personash, si edhe si ngacmim, ofendim, stereotipizim, stigmatizim apo kërcënim ndaj personit apo grupi personash dhe justifikimi i të gjitha llojeve të mëparshme të shprehjes mbi shkaqet e racës, ngjyrës, prejardhjes, përkatësisë kombëtare apo etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë apo besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe karakteristikave të tjera personale apo statusit”*.

Rekomandimi Nr. 15 i Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) *“Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”*, i përkufizon termat “stereotipizim negativ” dhe “stigmatizim” si vijon: *“stereotipizim negativ” nënkupton një opinion të përgjithshëm sikur një pjesëtar apo pjesëtarët e një grupi personash kanë karakteristika të caktuara, duke i vlerësuar me negativitet, pavarësisht karakteristikave të veçanta të pjesëtarit apo pjesëtarëve fjalë; “stigmatizim” nënkupton etiketimin e një grupi personash në një mënyrë negative;”*

Relacioni Shpjegues që shoqëron Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”, thekson se, një nga elementët domethënës të konceptit se çfarë është gjuha e urrejtjes, lidhet me përdorimin që synon jo thjesht të nxitë kryerjen e akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit, por edhe pritshmërinë e arsyeshme që ky përdorim të ketë këto efekte. Relacioni Shpjegues i Rekomandimit Nr.15, të ECRI-t, në pikën 16, të tij, përcakton se, vlerësimi nëse ekziston rreziku i akteve përkatëse, pra i akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit, që të ndodhin duhet të merret duke pasur parasysh

⁹ Në vijim referohet me akronimin Rekomandimi Nr.15, i ECRI-t.

rrethanat specifike në të cilat përdoret gjuha e urrejtjes dhe konkretisht duhet të vlerësohen këto elementë:

- a) konteksti në të cilin po përdoret gjuha e urrejtjes në fjalë (konkretisht, nëse ekzistojnë tashmë tensione të rënda brenda shoqërisë ku përcillet kjo gjuhë e urrejtjes);
- b) aftësinë e personit që përdor gjuhën e urrejtjes për të ushtruar ndikim mbi të tjerët (p.sh. duke qenë udhëheqës politik, fetar ose komunitar);
- c) natyrën dhe forcën e gjuhës së përdorur (p.sh. nëse është provokuese dhe e drejtpërdrejtë, përfshin përdorimin e keqinformimit, stereotipizimin negativ dhe stigmatizimin, ose është në gjendje të nxitë akte dhune, frikësimi, armiqësie ose diskriminimi);
- d) kontekstin e komenteve specifike (nëse janë një dukuri e izoluar ose janë ritheksuar disa herë dhe nëse ato mund të vlerësohen si të kundërbalancuara nga të tjerët ose nga vetë folësi apo dikush tjetër, sidomos gjatë një debati);
- e) mediumin (formatin) e përdorur (nëse mundëson përgjigje të menjëhershme nga publiku, për shembull një aktivitet që ndodh "direkt");
- dhe f) natyrën e publikut (nëse ka në dispozicion mjetet dhe prirjen apo ndjeshmërinë për t'u përfshirë në akte dhune, frikësimi, armiqësie ose diskriminimi)¹⁰.

Rekomandimi KM/Rek (2022)16, i Komitetit të Ministrave, të Këshillit të Evropës, për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes, rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare, të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e shpejtë dhe të plotë të parimeve dhe udhëzimeve të dhëna nëpërmjet këtij rekomandimi. Në shtojcën e Rekomandimit KM/Rek (2022)16, të Komitetit të Ministrave, të Këshillit të Evropës, për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes, theksohet se, meqenëse gjuha e urrejtjes mbulon një sërë shprehjesh urrejtjeje, të cilat ndryshojnë në ashpërsinë e tyre, dëmin që shkaktojnë dhe ndikimin e tyre te anëtarët e grupeve të veçanta në kontekste të ndryshme, shtetet anëtare duhet të sigurojnë që një sërë masash për të parandaluar dhe luftuar efektivisht gjuhën e urrejtjes. Një qasje e tillë gjithëpërfshirëse duhet të përputhet plotësisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën gjyqësore përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Gjykata) dhe duhet të bëjë dallimin ndërmjet:

- i. gjuhës së urrejtjes që është e ndaluar sipas ligjit penal;
- ii. Gjuhës së urrejtjes që nuk arrin nivelin e ashpërsisë së kërkuar për përgjegjësinë penale, por megjithatë i nënshtrohet *ligjit civil ose administrativ*;
- iii. Llojet fyese ose të dëmshme të shprehjes, të cilat nuk janë mjaftueshëm të rënda për t'u kufizuar në mënyrë legjitime sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por megjithatë kërkojnë përgjigje alternative, siç janë: kundër-fjalimi dhe kundërmasa të tjera; masat që nxisin dialogun dhe

¹⁰ Rekomandimi Nr.15, i ECRI-t, Relacioni Shpjegues, Pjesa B “Përkufizime”, nën-ndarja “Përkufizimi i gjuhës së urrejtjes”, pika 16.

mirëkuptimin ndërkulturor, duke përfshirë mediat dhe mediat sociale, dhe aktivitete përkatëse edukative.

Në Shtojcën e Rekomandimit KM/Rek (2022)16, theksohet se, në vlerësimin e ashpërsisë së gjuhës së urrejtjes dhe përcaktimin se cila lloj përgjegjësie, nëse ka vend për përgjegjësi, duhet t'i atribuohet ndonjë shprehjeje specifike, duhen ndjekur udhëzimet e dhëna nga praktika gjyqësore përkatëse e GJEDNJ, duke marrë parasysh faktorët e mëposhtëm dhe ndërveprimi ndërmjet tyre: - *përmbajtja e shprehjes*; - *konteksti politik dhe social në kohën e shprehjes*; - *qëllimi i folësit*; - *roli dhe statusi i folësit në shoqëri*; - *si shpërndahe apo përforcohet shprehja*; - *aftësia e shprehjes për të çuar në pasojë të dëmshme, duke përfshirë afërsinë e pasojave të tilla*; - *natyra dhe madhësia e audiencës dhe karakteristikat e grupit të synuar*.

Kufizimi i gjuhës së urrejtjes kërkon pajtim të dy grupeve të vlerave: kërkesat e shoqërisë demokratike për të lejuar debat të hapur dhe autonomi dhe zhvillim individual me detyrimin gjithashtu bindës, për të parandaluar sulmet ndaj komuniteteve vulnerabël dhe për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë dhe jodiskriminuese të të gjithë individëve në jetën publike. Në këtë kontekst, çështja thelbësore që shtrohet në çështjen objekt shqyrtimi, është pesha respektive që ka liria e shprehjes, në raport me të drejtën për të jetuar të lirë nga diskriminimi dhe për të gëzuar respekt të barabartë, të të gjithë personave pavarësisht orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor.

Sa më sipër rezulton se, kufizimi i lirisë së shprehjes, është një kërkesë e imponuar nga parashikimi që bëhet në LMD, i cili sanksionon se gjuha e urrejtjes përbën një nga format e shfaqjes së diskriminimit dhe se çdo formë diskriminimi e parashikuar nga ky ligj, është e ndaluar.

Gjithashtu, rezulton plotësisht e qartë se, kufizimi i lirisë së shprehjes, të pretenduar nga subjektet ankues, kërkohet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, që në rastin konkret është sigurimi i barazisë dhe mbrojtja nga diskriminimi të personave për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual të tyre.

Në këtë mënyrë përmbushen dy kushtet mbi bazën e të cilave mund të kufizohet liria e shprehjes. Kushti i parë që kufizimi bëhet me ligj dhe në rastin konkret një kufizim i tillë përcaktohet në kuadër të LMD. Ndërkohë që, kushti i dytë, sipas të cilit kufizimi mund të justifikohet vetëm për shkaqet e përcaktuara shprehimisht nga Kushtetuta, përlijet me faktin se, mbrojtja e të drejtave të personave LGBTI, si në rastin objekt shqyrtimi, përbën një prej shkaqeve kufizuese të përcaktuara nga Kushtetuta. Ajo që mbetet të vlerësohet është domosdoshmëria dhe proporcionaliteti.

Sipas Rekomandimit Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”¹¹, “shprehja” në këtë Rekomandim përfshin fjalët dhe publikimet në çfarëdo formë, përfshirë edhe përmes medias elektronike, si edhe përhapjen dhe ruajtjen e tyre. Gjuha e urrejtjes mund të marrë formën e fjalëve të shkruara apo të shqiptuara, apo forma të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, piktura, muzikë, pjesë teatrale apo video. Gjithashtu, përfshin përdorimin e një sjelljeje të caktuar - siç janë gjestet - për të komunikuar një ide, mesazh apo mendim.

“Gjuha e urrejtjes”, si një formë diskriminimi, sipas LMD-së, nënkupton përdorimin e një ose më shumë *formave të shprehjes*, përkatësisht, promovimin ose nxitjen e denigrimit, urrejtjes apo shpifjes të një personi ose grupi personash, si dhe çdo shqetësim, fyerje, stereotipizim negativ, stigmatizim ose kërcënim i një personi ose personave të tillë dhe çdo justifikim të të gjitha këtyre formave të shprehjes, që bazohet në një listë të hapur të shkaqeve të mbrojtura nga diskriminimi, të parashikuara në nenin 1, të LMD-së, ku në mënyrë të shprehur parashikohen shkakut i identitetit gjinor dhe orientimit seksual.

Në jurisprudencën e saj, GJEDNJ, kur merret me çështjet që kanë të bëjnë me nxitjen e urrejtjes dhe lirinë e shprehjes, përdor dy qasje të parashikuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut:

- qasja e përjashtimit nga mbrojtja e Konventës, e parashikuar nga neni 17 (ndalimi i abuzimit me të drejtat), ku komentet në fjalë përbëjnë gjuhë urrejtje dhe mohojnë vlerat themelore të Konventës; dhe
- qasja e vendosjes së kufizimeve në mbrojtje, e parashikuar nga neni 10, paragrafi 2, i Konventës (kjo qasje zbatohet kur shprehja në fjalë, megjithëse është gjuhë urrejtjeje, nuk është e përshtatshme për të shkatërruar vlerat themelore të Konventës).

“Gjuha e urrejtjes”, siç është interpretuar ky koncept në praktikën gjyqësore të GJEDNJ, ndahet në dy kategori. *Kategoria e parë* e praktikës gjyqësore të GJEDNJ për “gjuhën e urrejtjes” përbëhet nga format më të rënda të “gjuhës së urrejtjes”, të cilat Gjykata i ka konsideruar se i përkasin nenit 17, dhe kështu janë përjashtuar tërësisht nga mbrojtja e nenit 10. *Kategoria e dytë* përbëhet nga forma “më pak të rënda” të “gjuhës së urrejtjes” të cilat Gjykata nuk i ka konsideruar se janë tërësisht jashtë mbrojtjes së nenit 10, por që ajo i ka konsideruar të lejueshme për shtetet kontraktuese t’i kufizojnë (shih, ndër të tjera, *Féret kundër Belgjikës*, nr. 15615/07, 16 korrik 2009, *Vejdeland dhe të tjerët kundër Suedisë*, 9 shkurt 2012; *Delfi AS kundër Estonisë*, 16 qershor 2016). Në këtë kategori të dytë, GJEDNJ, jo vetëm që ka vendosur gjuhën që bën thirrje në mënyrë eksplicite për dhunë ose akte të tjera kriminale, por ka vendosur se, sulmet ndaj personave, të kryera duke fyer, tallur ose shpifur për grupe të veçanta të popullsisë, mund të jenë të mjaftueshme për të lejuar autoritetet të favorizojnë luftën kundër gjuhës paragjyqëse brenda kontekstit të kufizimeve të lejuara për lirinë e shprehjes (shih *Beizaras dhe Levickas kundër Lituanisë*; *Vejdeland dhe të*

¹¹ Referuar, pikës 11, të Relacionit Shpjegues, që shoqëron Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”

tjerët kundër Suedisë dhe Féret kundër Belgjikës). Në rastet që kanë të bëjnë me gjuhën që nuk thërret për dhunë apo akte të tjera kriminale, por që megjithatë GJEDNJ i ka konsideruar si “gjuhë urrejtjeje”, ky përfundim është bazuar në një vlerësim të përmbajtjes së shprehjes dhe mënyrës së dhënies së saj¹².

Komisioneri, thekson se, deklarat objekt shqyrtimi, nuk përfshihen në format më të rënda të “gjuhës së urrejtjes”, të cilat mohojnë vlerat themelore të KEDNJ dhe që janë të përjashtuara nga mbrojtja e KEDNJ-së, parashikuar nga neni 17, i saj.

Për të vlerësuar nëse ekziston rreziku që aktet e promovuara ose të nxitura nga gjuha e urrejtjes të ndodhin, Komisioneri ka marrë në konsideratë rrethanat e mëposhtme, në përputhje me frymën e Rekomandimit Nr. 15 të ECRI-t dhe Rekomandimin KM/Rek (2022)16, të Komitetit të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

Komisioneri vlerëson se, në rastin objekt shqyrtimi shprehja është realizuar nëpërmjet fjalëve të deklaruara dhe në mënyrë publike, pasi gjuha në shqyrtim e përdorur nga S. C., është bërë gjatë një proteste të mbajtur pranë Bashkisë së Tiranës, e cila përfshihet në mjetet e përhapjes së gjuhës së urrejtjes.

Rezulton se, më datë 25.10.2024, në protestën e zhvilluar nga forcat opozitare pranë Bashkisë Tiranë, S. C. është shprehur ndër të tjera se: “*Mos prisni asnjë gjë nga ndërkombëtarët. OSBE çon formularët në Parlament dhe i pyet gratë dhe burrat çfarë gjinie keni ju, çfarë gjinie kanë shqiptarët? Shqiptarët nuk janë pederastë. Shqiptarët janë burra dhe shqiptarët janë gra. Fëmijët tanë janë vajza dhe djem, dhe kjo duhet të jetë një vijë e cila nuk duhet të shkelet. Ka ditë, ka muaj, ka vite që po tentohet të shkelet. Është agjendë, e kemi paralajmëruar. E kemi paralajmëruar dhe jam shumë e bindur që shqiptarët dita ditës po e kuptojnë...*”.

Subjektet ankues, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Aleanca kundër Diskriminimit LGBT, kanë pretenduar se gjatë fjalimit të mbajtur nga ana e S. C. është përdorur një gjuhë jo e përshtatshme, gjuhë të cilën ata e konsiderojnë “gjuhë urrejtjeje” kundrejt komunitetit LGBTI+ për shkaqe që kanë të bëjnë me orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

Pikërisht përse më lart, subjektet ankues, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Aleanca kundër Diskriminimit LGBT, kanë paraqitur ankesë kundër S. C., në të cilën pretendohet për diskriminim në formën e “gjuhës së urrejtjes”, për shkak të orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

¹² GJEDNJ, *Carl Jóhann Lillendahl kundër Islandës*, Aplikimi nr. 29297/18, Vendimi datë 12 maj 2020.

Nga informacioni i administruar u arrit të konstatohet se fjalimi i mbajtur nga S. C., në datë 25.10.2024, ishte shpërndarë dhe bërë publik në të paktën 2 media në rrjetet e tyre sociale. Ndër to ishte Televizioni Ora News¹³ dhe media Zëri Albania¹⁴.

Në rastin konkret, institucioni i Komisionerit ka zbatuar detyrimet ligjore të parashikuara jo vetëm në ligjin e tij rregullator, por dhe detyrimet e parashikuara në ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, pavarësisht se, referuar nenit 78¹⁵, të tij, materiale të tilla, lejohen të riprodhohen pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen për përdorimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore, administrative.

Për rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, si dhe në parashtrimet e depozituara nga pala ankuese, Komisioneri, ka analizuar kontentin e deklaratave, shprehjeve dhe qëndrimit të S. C., në daljen publike në protestën e datës 25.10.2024.

Nga këqyrja e analizimi i gjuhës së përdorur në këtë dalje publike të S. C., lidhur me pjesën e pretenduar nga pala ankuese, Komisioneri saktëson se, ka analizuar gjuhën e përdorur, qëndrimin dhe deklaratën e saj në protestën e zhvilluar pranë Bashkisë Tiranë më datë 25.10.2024, referuar transkriptit më lart, i cili ka vlerësuar nëse potencialisht kishte premisa për një gjuhë që shkon në tejkalim të lirisë së shprehjes.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: “Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.”

Gjuha e përdorur nga S. C. në daljen publike në protestën e datës 25.10.2024, e cila është objekt shqyrtimi në këtë çështje, është bërë publike dhe si të tillë deklaratimet e subjektit konsiderohen të njohura publikisht dhe Komisioneri ka administruar për efekt të hetimit administrativ regjistrimin ku janë bërë deklaratimet të cilat janë marrë në shqyrtim.

Në kontekst të gjuhës së përdorur nga S. C. në daljen publike sipërcituar, Komisioneri, thekson se:

Statusi i subjektit, S. C., si përfaqësuese e subjektit politik Partia e Lirisë, ka një aftësi të shtuar për të ushtruar ndikim tek një publik i gjerë nëpërmjet deklaratave të saj. Duke u bazuar tek statusi i

¹³ <https://www.youtube.com/watch?v=7Cw1OyY7luI>.

¹⁴ <https://www.instagram.com/reels/DBi6m75tTbC/>.

¹⁵ “Përdorimi i veprave për procedura gjyqësore, administrative dhe procedura të tjera zyrtare” parashikon se: “Veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen me sigurinë publike, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore, administrative, parlamentare dhe procedurave në arbitrazh, përveçse në rastin e përmbledhjeve”.

saj, S. C. mbart detyrime të shtuara, në raport me persona të tjerë të cilët nuk kanë një profil publik dhe politik, për të treguar një vigjilencë të shtuar në lidhje me gjuhën që përdor gjatë ushtrimit të lirisë së shprehjes. Për shkak të statusit dhe ndikimit që ka tek të tjerët, subjekti duhet të tregojë një përgjegjshmëri më të madhe në lidhje me gjuhën e përdorur për të transmetuar qëndrimet, mendimet apo mesazhet.

Përhapja e deklaratave nëpërmjet medias audiovizive si dhe prezenca *online* në rrjetin social në Instagram¹⁶ apo edhe në Youtube¹⁷, ku pasqyrohen deklaratat e pretenduara si diskriminuese, ka mundësinë që të arrijë tek një publik dhe audiencë e madhe. Referuar komenteve të publikut në faqen e Instagram të medias Zëri Albania, janë shfaqur 182 komente dhe 2025 pëlqime. Nga analiza e bërë komenteve, nga 6 komente sa i takon deklaratës, evidentohet se vetëm në një rast gjuha e përdorur mund të cilësohet e papranueshme. Pjesa më e madhe e komenteve kanë natyrë politike dhe shënjestrojnë deklaruesit politikisht.

Ndërsa sa i takon kanalit *Youtube* publikimi është parë 1300 herë dhe ka 8 pëlqime dhe 19 komente të cilat nuk evidentohen të kenë gjuhë të papranueshme. Gjithashtu theksojmë se publikimi është 6 minuta dhe kryesisht ka karakter politik dhe teza në kuadër të fushatës elektorale. Deklaratat që pretendohen që përbëjnë gjuhë urrejtje nuk përbëjnë thelbin e këtij fjalimi.

Format e shprehjes që fyejnë, tronditin, shqetësojnë apo çdo formë tjetër e dëmshme e shprehjes, nuk përbëjnë gjuhë urrejtje, vetëm mbi këtë bazë. Masat ligjore të parashikuara nga LMD mund të përdoren vetëm ndaj formave të shprehjes që kanë qëllim që të nxisin, apo kanë pritshmërinë e arsyeshme që të kenë efektin e nxitjes të të tjerëve për të kryer akte dhune, frikësimi, armiqësie apo diskriminimi ndaj personave ose grupeve të shënjestruar. Vetëm këto forma të shprehjes do të konsiderohen gjuhë urrejtje dhe diskriminim sipas LMD, e rrjedhimisht do të shërbenin si një arsye e përligjur dhe e domosdoshme në një shoqëri demokratike për të kufizuar lirinë e shprehjes.

Në vlerësimin e ashpërsisë së shprehjeve dhe përcaktimin nëse ato përligjin nivelin e ashpërsisë së kërkuar për t'u konsideruar gjuhë urrejtje, elementët/faktorët që merren në konsideratë nuk vlerësohen veçmas njëri tjetrit, por vlerësimi i ashpërsisë së gjuhës së përdorur është rezultat i ndërveprimit midis tyre.

Nga shqyrtimi i plotë i kontekstit dhe ndikimit të mundshëm të fjalëve konkrete të përdorura nëpërmjet të cilave është shprehur mosdakordësia e subjektit S. C. në lidhje me çështje që prekin të drejtat e komunitetit LGBTI, Komisioneri vlerëson se natyra dhe forca e fjalëve, si dhe fakti që videoja e publikuar nuk evidentohet të ketë patur një shpërndarje të gjerë në internet dhe nuk ka ngjallur reagim në publik, nuk kanë fuqinë që të nxisin apo pritshmërinë e arsyeshme që të kenë efektin e nxitjes të të tjerëve për të kryer akte dhune, frikësimi, armiqësie apo diskriminimi ndaj komunitetit LGBTI.

¹⁶ <https://www.instagram.com/reels/DBi6m75tTbC/>.

¹⁷ <https://www.youtube.com/watch?v=7Cw1OyY7luI>.

Në vendimin e saj të datës 4 qershor 2024, në çështjen Sokolovski kundër Ruisë, GJEDNJ ka theksuar rëndësinë e shqyrtimit të plotë të kontekstit dhe ndikimit të mundshëm të fjalëve ofenduese, fyese ose agresive, me qëllim që të bëhet dallimi ndërmjet fjalës së mbrojtur sipas nenit 10 dhe fjalës që nuk mund të tolerohet në një vend demokratik, sepse përbën nxitje të urrejtjes, diskriminimit, dhunës ose intolerancës. GJEDNJ thekson gjithashtu se, frenimi i një rreziku të thjeshtë spekulativ, si një masë parandaluese për të mbrojtur demokracinë, nuk mund të konsiderohet si përgjigje ndaj një “nevojë urgjente sociale”.

Nga shqyrtimi i plotë i kontekstit dhe ndikimit të mundshëm të fjalëve të përdorura, Komisioneri vlerëson se natyra dhe forca e fjalëve në kontekstin social në kohën kur ato janë përdorur, nuk rezultojnë që të kenë prodhuar ndikime ose efekte tek audienca apo publiku.

Evidentohet se S. C. në cilësinë e anëtares së Këshillit Bashkiak Tiranë dhe ish-deputete ka votuar gjithnjë në favor të iniciativave ligjore dhe nënligjore që mbështesin komunitetin LGBTI, si në rastin e votimit të projektvendimit për subvencionimin e interesave të kredisë ku anëtarët LGBTI përfitonin pikë shtesë. Kjo tregon se përmes veprimeve S. C., nuk ka mbajtur një qëndrim strukturalisht diskriminues ndaj këtij komuniteti.

Gjithashtu Komisioneri sjell në vëmendje edhe reflektimin e subjektit S. C. përmes e-mail-it datë 27.01.2026 drejtuar Komisionerit ku ndër të tjera thekson:

“..... duke mos patur për qëllim fyerjen apo diskriminimin, dëshiroj që nëpërmjet Jush, edhe si një individ që beson tek të drejtat e njeriut, si nënë dhe mbi të gjitha si njeri që e ka të shenjtë jetën dhe shëndetin e kujtdo, qofshin këta homoseksualë apo jo, t’i kërkoj ndjesë çdokujt, që nga ajo deklaratë është ndjerë i diskriminuar. Për asnjë moment nuk kam patur qëllim diskriminimin, por vetëm mbrojtjen e një ideje, të cilën unë e besoj dhe e vlerësoj si të drejtë, të paktën për aq kohë sa realiteti ynë shoqëror, moral dhe ligjor mbetet në fuqi dhe nuk ka ndryshuar.”

Për më tepër, Komisioneri mban në konsideratë edhe faktin që ky moment i pretenduar nga ana e subjekteve ankues, është një moment i veçantë dhe nuk ka patur ndonjë jehonë të mëtejshme apo komentime, në media apo platforma të ndryshme sociale që të ketë përcjellë në publik shqetësim apo të krijojë dyshime për ndonjë ndikim të mundshëm negativ i cili të ketë afektuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi komunitetin e personave LGBTI.

Komisioneri ka vlerësuar se momenti i pretenduar nga subjektet ankues ka qenë i izoluar, pa jehonë apo reagime të mëtejshme në media dhe rrjete sociale që të krijojnë shqetësim publik ose dyshime për ndikim negativ ndaj personave LGBTI. Gjithashtu, është konstatuar se citimi fragmentar gjatë protestës nuk kishte për qëllim stigmatizimin, stereotipizimin negativ apo nxitjen e frikës, armiqësisë dhe diskriminimit ndaj kësaj kategorie. Për pasojë, gjuha e përdorur dhe konteksti i përgjithshëm i diskursit nuk janë konsideruar me intensitet apo natyrë të tillë që të përbëjnë diskriminim ose gjuhë urrejtjeje ndaj personave LGBTI.

Përfundimisht, Komisioneri arrin në konkluzionin se, shprehjet dhe gjuha e përdorur nga S. C. gjatë fjalimit të mbajtur në protestën e zhvilluar më datë 25.10.2024, pranë Bashkisë Tiranë, nuk përbën “gjuhë urrejtje¹⁸” në kuptim të nenit 3, pika 8, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe për rrjedhojë Komisioneri nuk konstaton shkelje të ligjit.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit në formën e “gjuhës së urrejtjes”, për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual, nga ana e S. C..
2. Me qëllim promovimin e komunikimit të kujdesshëm dhe respektues në hapësirën publike, Komisioneri rekomandon S. C. që në të ardhmen të tregojë vëmendje të shtuar, për të shmangur shprehjet apo deklaratat që mund të perceptohen si cenim i dinjitetit ose të kenë ndikim negativ ndaj kategorive të caktuara shoqërore.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

(Shkaku: Identiteti gjinor dhe orientimi seksual)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)

¹⁸ Nga praktika e KMD-së për rastet e ngjashme, citojmë vendimet e Komisionerit, me: nr. 218/2021, nr. 233/2021, nr. 109/2022, nr. 250/2023, nr. 149/2023, nr. 79/2024, nr. 297/2024.